

Parashkollorja është për fëmijën tënd

NJË BROSHURË MBI PLANIN MËSIMOR PARASHKOLLOR



Skolverket



Ti je me rëndësi

Ti je më i afërmi i fëmijës tënd. Prandaj pikëpamjet e tua janë të rëndësishme për parashkolloren. Nëse ti na thua se çka mendon atëherë është më lehtë për personelin që t'ia japë fëmijës tënd atë që i nevojitet. Nëse do të marrësh pjesë dhe të ndikosh në punën e parashkollorës atëherë duhet të dish se si funksionon parashkollorja.

Drejt cakut të njëjtë

Qeveria ka caktuar një plan mësimor ku po ashtu shkruhet mbi themelin e vlerave të parashkollorës dhe mbi caqet dhe detyrat e parashkollorës. Duke e lexuar planin mësimor të parashkollorës mundesh të kuptosh se çka mundesh të presësh dhe kërkosh nga parashkollorja.

Ka parashkollore komunale dhe parashkollore të pavarura. Për parashkolloret komunale përgjegjësinë e mban një këshill me përfaqësues politikë të zgjedhur. Për parashkolloret e pavarura përgjegjësinë e mbajnë kryesitë e tyre. Të gjitha parashkolloret duhet t'i përmbahen planit mësimor.

Si rregull parashkollorja i përfshin fëmijët e moshës 1 deri më 6 vjeç. Të gjithë fëmijët e moshës 3-6 vjeç kanë të drejtë për parashkollore të papaguar, për 525 orë në vit.



» Në parashkollore fëmijët duhet të takojnë të rritur që i shikojnë mundësitë e çdo fëmije.«

NGA PLANI MËSIMOR PARASHKOLLOR (FÖRSKOLANS LÄROPLAN), LPFÖ 98 (REVIDUAR MË 2010)



Hap pas hapi në të mësuar për tërë jetën

Parashkollorja duhet të pushojë mbi themelet e demokracisë. Në shkallë të gjerë kjo ka të bëjë me atë që personeli duhet të krijojë një klimë të hapur dhe demokratike ku secili fëmijë duhet ta përjetojë vlerën e vet dhe vlerën e të tjerëve

Veprimtaria e parashkollorës duhet të cilësohet nga një pedagogji ku përkujdesja, kujdesi, edukimi dhe të mësuarit formojnë një tërësi të përbashkët. Kjo do të thotë që parashkollorja pikësisht ekziston për hir të fëmijës tënd, edhe pse ajo po ashtu duhet të të mundësojë ty të punosh ose të studijosh.



Në planin mësimor shkruan që loja është e rëndësishme për zhvillimin dhe të mësuarin e fëmijës. Personeli duhet t'i marrë parasysh pikëpamjet, interesat dhe përvojat e vetë fëmijës në planifikimin e punës së përditshme. Fëmijëve duhet të u jepet mundësia të provojnë të shprehen në mënyra të ndryshme, edhe vetë edhe së bashku me të tjerët, për shembull me këngë e muzikë, vizatime, vallëzime, dramë, me fjalë dhe me shkrim.

Fëmijëve duhet të u jepet mundësia ta zhvillojnë identitetin e vet kulturor. Zhvillimi gjuhësor i fëmijës është një fushë e rëndësishme në parashkollore. Parashkollorja duhet të kontribuojë që një fëmijë me gjuhë amtare të ndryshme nga suedishtja të ketë mundësi ta zhvillojë edhe gjuhën suedishte edhe gjuhën e vete amtare.

Parashkollorja duhet t'i kundërshtojë mostrat dhe rolet tradicionale gjinore. Të gjithë vajzave dhe djemve duhet të u jepet mundësia e njejtë e zhvillimit, pa kufizime.



Çdo parashkollore është e veçantë

Plani mësimor duhet të garantojë që të gjithë fëmijët të kenë një parashkollore njësoj të mirë, pa marrë parasysh se ku banojnë. Pasiqë të gjitha parashkolloret i përmbahen planit të njëjtë mësimor ato i kanë edhe caqet e njëjta. Mënyra e punës mundet megjithatë të ndryshojë. Ajo që përshtatet në një parashkollore ndoshta nuk shkon në një tjetër. Veprimtaria duhet të përshtatet sipas fëmijëve.

Komuna ose kryesia e parashkollores së pavarur e kanë përgjegjësinë e skajshme për parashkolloren. Nëse dalin probleme të cilat nuk munden të zgjidhen nga ti dhe personeli ose udhëheqësia e shkollës, atëherë mundesh të u drejtohesh atyre.

» Parashkollorja duhet t'i frymëzojë fëmijët që ta hulumtojnë botën përreth.«

NGA PLANI MËSIMOR PARASHKOLLOR (FÖRSKOLANS LÄROPLAN), LPFÖ 98 (REVIDUAR MË 2010)





Bashkëpunim me shtëpinë

Në planin mësimor shkruan që puna e parashkollores duhet të zhvillohet në një bashkëpunim të afërt e besimplotë me shtëpinë. Prandaj është me rëndësi që ti të bisedosh me personelin nëse ke diçka që do të dish. Një rast i mirë për këtë janë marrja e lënja e fëmijës. Në këto raste personeli duhet të të tregojë ty se si ka kaluar fëmija gjatë ditës. Ti mundesh po ashtu të tregosh nëse ka ndodhur diçka e veçantë për çka mundet të jetë mirë të njoftohet personeli.

Personeli duhet të përgatisë biseda vlerësim-zhvillimi (utvecklingssamtal) ku do të diskutoni mbi atë se si kalon dhe zhvillohet fëmija dhe si funksionon parashkollorja. Plani mësimor duhet të shërbejë si një mbështetje për bisedën.

» Parashkollorja duhet të jetë dëfryese, e sigurt dhe mësimplotë për të gjithë fëmijët që marrin pjesë.«

NGA PLANI MËSIMOR PARASHKOLLOR (FÖRSKOLANS LÄROPLAN), LPFÖ 98 (REVIDUAR MË 2010)



Do ta lexosh tërë planin mësimor?

Plani mësimor gjendet në të gjitha parashkolloret. Plani mësimor mundet të porositet ose të merret nga sajti i Entit Arsimor (Skolverket) www.skolverket.se.

ISBN 978-91-87115-07-3

Grafisk form: AB Typoform

Omslagsfoto: Maskot

Foto inlaga: s 2 NordicPhotos, s 3 Kzenon/Shutterstock,

s 4 Yulya Shilova/Shutterstock, s 5 Michael McLain, s 6 NordicPhotos

Skolverket 2011

Skolverket